



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.50, datë 16/09/2005

**“MBI
MIRATIMIN E NORMATIVAVE TË UNIFORMAVE TË PUNËS PËR
PUNONJËSIT E SEKTORIT TË INFORMIMIT QYTETAR, RECEPTIONIT,
DHE TE SHËRBIMIT TË ROJËS SË BRËNDSHME TË BASHKISË SË
TIRANËS”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dates 16/09/2005, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës “Mbi miratimin e normativave të uniformave të punës për punonjësit e Sektorit të Informimit Qytetar, Receptionit dhe të Shërbimit të Rojes së Brëndshme të Bashkisë së Tiranës”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “k”, në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr.7961, dt.12/07/1995, nenet 71 dhe 125 pika 1, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Miratimin e normativave të uniformave të punës për punonjësit e Sektorit të Informimit Qytetar, Receptionit dhe të Shërbimit të Rojes së Brëndshme të Bashkisë së Tiranës, sipas tabelave Nr.1 dhe 2 bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Këto normativa zbatohen për punonjësin, që përfiton sipas kuotës në vendimin, me fillimin e marrëdhënies së punës.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI